




# Katër raste të armëmbajtjes paleje raportohen brenda ditës në rajonin e Prishtinës

LAJME




08/03/2022 08:58

**Të shpeshta janë rastet e të shtënave me armë në Kosovë. Shumë prej tyre madje kanë përfunduar edhe me të lënduar e deri edhe në viktima.**

Në raportin 24 orësh të Policisë së Kosovës është raportuar se brenda një dite polici ka gjetur dhe sekuestruar armë të ndryshme paleje.



Dyqani Ekskluziv Enzo Attini ne Shqipëri. Tek Sheshi...
Reklame nga boost.al | Enzo Attini

Katër raste janë raportuar vetëm në rajonin e Prishtinës, transmeton lajmi.net.

**Njoftimi i plotë:**

ARMËMBAJTJE PA LEJE

• Rr.27 Nëntori, Prishtinë 07.03.2022 – 02:30. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi gjatë kontrollit në veturën e tij është gjetur dhe sekuestruar një armë e ftohtë-thikë. Pas intervistimit me urdhër të prokurorit i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

• Fsh.Vragoli, Fushë Kosovë 07.03.2022 – 15:00. Është raportuar se në lokalin e të dyshuarit mashkull kosovar është gjetur dhe konfiskuar një armë me gaz. I dyshuari është intervistuar dhe është njoftuar prokurori. Rasti është duke u hetuar.

• Fsh. Arllat, Gllogoc 07.03.2022 – 12:40. Njësiti policor ka ndaluar një automjet me ngasës mashkull kosovar tek i cili gjatë kontrollit është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë me 7 copë fishekë. I dyshuari është shoqëruar në stacion policor dhe pas intervistimit, me urdhër të prokurorit është liruar në procedurë të rregullt.

• Rr. Ibrahim Lutfiu, Prishtinë 07.03.2022 – 12:55. Është shoqëruar në stacion policor i dyshuari mashkull kosovar nxënës për shkak se i është gjetur dhe sekuestruar një thikë. Në konsultim me prokurorin rasti shkon në procedurë të rregullt**./Lajmi.net/**

## Artikuj të ngjashëm



March 8, 2022
Vdes nëna e Bedri Hamzës



March 8, 2022
Situata në Ukrainë: Presidenti kinez flet me Francën e Gjermaninë



March 8, 2022
Reportazh i BBC-së në Moskë: Kështu e kanë katandisur Rusinë sanksionet...



March 8, 2022
Bashkëshortja e Agim Ramadanit: Sot m'u kujtua kur ai më dhuroi...



March 8, 2022
Koloneli britanik: Serbia nuk është në pozitë të hyjë në Kosovë,...



March 8, 2022
Mehaj falënderon ushtaret e Kosovës që sollën lirinë dhe ato që...




## LAJME TË FUNDIT



A u nda Leonora Jakupi nga 'baba i tenderëve'? Tregon këngëtarja...



Vdes nëna e Bedri Hamzës



Formacionet zyrtare: Bayern Munich – RB Salzburg



Formacionet zyrtare: Liverpool – Inter






info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5



©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved